



Dokument tematik

**RIINTEGRIMI I TË
MBIJETUARAVE NGA
DHUNA ME BAZË GJINORE**

2023

Dokument tematik

**RIINTEGRIMI I TË
MBIJETUARAVE NGA
DHUNA ME BAZË GJINORE**

Studim

2023



This project is funded
by the European Union



DIFFERENT & EQUAL
TE NDRYSHËM & TE BARABARTE



Autor: Të Ndryshëm & Të Barabartë (D&E)

Eksperte: Irida Agolli Nasufi

Kontribues: Mariana Meshi, Stela Tanellari, Rovena Balla, Burbuqe Meçaj, Genta Hoxha

Citimi i sugjeruar: I. Agolli, M. Meshi, S. Tanellari, R. Balla, B. Meçaj, G. Hoxha (2023), *Riintegrimi i të mbijetuarave nga dhuna me bazë gjinore*. Tiranë: "Të Ndryshëm & Të Barabartë".

Dokument tematik "Riintegrimi i të mbijetuarave nga dhuna me bazë gjinore" është përgatitur nga organizata "Të Ndryshëm & Të Barabartë" në kuadër të projektit "Ofrimi i programeve të riintegritit ekonomik për të paktën 80 gra në bashkitë e Kukësit, Dibrës, Korçës dhe Beratit, përfshirë edhe gratë e grupeve vulnerabël", me mbështetjen e UN Women në kuadër të programit "Fund dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi Faza II", financuar nga Bashkimi Europian.

Tabela e Përmbajtjes

I. HYRJE	5
II. SHKURTIME	8
III. PËRKUFIZIME	9
IV. SHËRBIMET RIINTEGRUESE PËR TË MBIJETUARAT E DHUNËS ME BAZË GJINORE	11
STREHIMI.....	11
Përshkrimi i shërbimit	11
Sfidat	12
Nevoja për strehim dhe akomodim	13
Praktikat e mira	13
Rekomandime	14
MBËSHTETJA PSIKOLOGJIKE DHE SOCIALE.....	14
Përshkrimi i shërbimit	14
Sfidat	16
Praktikat e mira	17
Rekomandime	18
SHËRBIMI SHËNDETËSOR DHE SHËNDETIT MENDOR	19
Përshkrimi i shërbimit	19
Sfidat	20
Praktikat e mira	21
Rekomandime	22
NDIHMA JURIDIKE	22
Përshkrimi i shërbimit	22
Sfidat	23
Praktikat e mira	24
Rekomandime	26
EDUKIMI DHE TRAJNIMI	27
Përshkrimi i shërbimit	27
Sfidat	27
Praktikat e mira	27
Rekomandime	28

PUNËSIMI DHE FUQIZIMI EKONOMIK	28
Përshkrimi i shërbimit	28
Sfidat	29
Praktikat e mira	30
Rekomandime	31
NDIHMJA DHE SHËRBIMET PËR FËMIJËT E VIKTIMAVE TË DHBGJ	32
Përshkrimi i shërbimit	32
Sfidat	33
Praktikat e mira	34
Rekomandime	35
INFORMIMI DHE REFERIMI.....	35
Përshkrimi i shërbimit	35
Sfidat	36
Praktikat e mira	36
Rekomandime	36
V. REKOMANDIME DHE KONKLUZIONE.....	38
VI. REFERENCA	41

I. HYRJE

Dhuna me bazë gjinore ndaj grave dhe vajzave përfaqëson një krizë globale. Në mbarë botën, gati një e treta e grave përjetojnë dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim ose dhunë seksuale nga jopartneri gjatë jetës së tyre (OBSH, 2021)¹. Kjo dhunë është endemike në të gjitha rajonet e botës, duke përfshirë edhe ato më të zhvilluara ekonomikisht.

Në Shqipëri, 1 në 2 gra, ose 52,9 % e grave pohojnë se kanë përjetuar të paktën një herë dhunë gjatë jetës së tyre nga partneri, dhe 36,6 % e grave pohojnë se aktualisht janë duke përjetuar dhunë. Dhuna ndaj grave dhe vajzave vijon të mbahet e fshehtë dhe përforcohet nga normat shoqërore, INSTAT (2020) pati evidentuar në anketën “Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri” se, 46,5 % e pjesëtarëve të komunitetit ku gratë e dhunuara jetojnë, besojnë se dhuna në familje duhet toleruar për të mbajtur familjen të bashkuar. Në të njëjtën kohë, dhuna fizike që përjetohet nga gratë në familje shihet kryesisht si faj i pjesëshëm i tyre, dhe bërja publike e përjetimit të dhunës jashtë rrethit familjar konsiderohet e turpshme (INSTAT, 2020)².

Shqipëria është vend burimi, tranziti dhe destinacioni për trafikimin e qenieve njerëzore, por mbetet kryesisht një vend burimi për trafikimin e qenieve njerëzore. Grupi i Ekspertëve për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA), 2016, Raport në lidhje me zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore nga Shqipëria³. Motivet që shtyjnë trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri janë të gjerë, të shumtë dhe shpesh të mbivendosur. Ka një mori faktorësh cenueshmërie që hyjnë në lojë për trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, duke përfshirë normat sociale dhe gjinore të dëmshme, varfërinë, nivelet e ulëta të arsimit, çështjet e shëndetit mendor, marrëveshjet për martesë të detyruara dhe mundësitë e kufizuara për migrim të sigurt dhe të ligjshëm⁴.

Zhvillimi në rrafshin legjislativ në Shqipëri për mbrojtjen e grave dhe vajzave nga fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës ka njohur progres të vazhdueshëm. Përmirësimet kanë qenë të shumta, në kuadër të trafikimit dhe dhunës ndaj grave, prej ku zhvillimet datojnë nga viti largët 1993, kur Shqipëria

¹ WHO. (2021). Violence Against Women Prevalence Estimates, 2018. Retrieved from <https://www.who.int/publications/i/item/violence-against-women-prevalence-estimates>

² INSTAT. (2020). Burrat dhe Gratë në Shqipëri.

³ Grupi i Ekspertëve për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA), 2016, Raport në lidhje me zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore nga Shqipëria;

⁴ Universiteti i Bedfordshire dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin. (IOM), 2019, “Midis dy zjarreve”: Kuptimi i cenueshmërive dhe nevojave për mbështetje të personave nga Shqipëria, Vietnam dhe Nigeria që kanë përjetuar trafikim njerëzor në MB”.

ratifikoi, Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave (CEDAW), si dhe protokollin e saj opsional në 2003. Kuadri ligjor në lidhje me mbrojtjen e grave në Shqipëri ka vijuar të përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë viteve përmes ratifikimit të një sërë konventash, traktatesh, amendamentesh dhe të një sërë dokumentesh të rëndësishëm ndërkombëtare si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Platforma për Veprim e Pekinit, Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, dhe Konventa e Stambollit, por jo vetëm⁵

Gratë dhe vajzat të mbijetuara nga dhuna me bazë gjinore kanë mundësinë t'i drejtohen një sërë institucioneve në nivel qendror dhe vendor. Rrethi i parë i shërbimeve përfshin Drejtoritë e Shërbimit Social në Bashki, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Komisaritet e Policisë së Shtetit, organizatave të ndryshme kombëtare dhe lokale, si dhe një sërë institucioneve të tjera qendrore dhe vendore⁶. Në nivel vendor disponueshmëria dhe tipologjia e shërbimeve multidisiplinare vazhdon të jetë e kufizuar dhe e nënfinancuar, përtej përpjekjeve individuale të bëra nga disa bashki për të përmirësuar rrjetin e shërbimeve në terren sa i takon strehëzave të emergjencës, strehimit afatgjatë dhe fuqizimit ekonomik të grave (MSHMS & UNDP, 2019)⁷.

Dokumentet politike që adresojnë çështjen e riintegrit të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore janë ambiciozë në raport me atë çfarë ofrohet për përfituesit, sidomos nga pushteti lokal. Ka vullnet nga ana e përfaqësuesve të institucioneve publike për të adresuar nevojën e riintegrit të të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore, por burimet dhe kapacitetet nuk janë në raport të drejtë me vullnetin dhe përgjegjshmërinë⁸.

Dokumenti aktual synon të nxjerrë në pah rëndësinë e një përgjigje të koordinuar duke u mbështetur në praktikën ekzistuese dhe të mëparshme të vendit përmes shërbimeve integruese që ju mundësojnë grave dhe vajzave rikthimin në një jetë normale dhe lehtësimin për riintegrimin e tyre në komunitet. Dokumenti do të shërbejë si një mjet i rëndësishëm për advokim me aktorë të rëndësishëm në nivel qendror dhe lokal me synimin për të mbështetur modelin e riintegrit dhe për të rritur mbështetjen dhe angazhimin e tyre për riintegrimin e të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore.

II. SHKURTIME

MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
CEDAW Grave	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
VT	Viktimë e trafikimit
VMT	Viktimë e mundshme e trafikimit
OJF	Organizata Jofitimprurëse
DHBGJ	Dhuna me bazë gjinore
DHF	Dhuna në Familje
INSTAT	Instituti i Statistikave
OShC	Organizatat e Shoqërisë Civile
MKR	Mekanizmi i koordinimit të referimeve të rasteve të dhunës në familje
ETN	Ekipi Teknik Ndërdisiplinar
GTN	Gurpi Teknik Ndërsektorial
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
PSV	Procedura Standarde Veprimi
ZRP	Zyra Rajonale e Punësimit
KVDHF	Koordinatori Vendor i Dhunës në Familje
NBGJ	Nënpunësi i Barazisë Gjinore
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

III. PËRKUFIZIME

Dhunë - sipas Ligjit 9669/2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" i ndryshuar me ligjin 47/2018, neni 3 përkufizohet: "Çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik"

Dhunë në familje - çdo akt dhune, që ndodh brenda familjes ose në një shtëpi, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën. (Ligji shqiptar "Për Masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" ndryshuar në vitin 2018)

Dhunë me bazë gjinore⁹ - "Dhuna që drejtohet ndaj një gruaje për shkak se është grua ose që ndikon tek gratë në mënyrë disproporcionale". Ajo përbën një shkelje të së drejtës themelore për jetesë, liri, siguri, dinjitet, barazi ndërmjet grave dhe burrave, mosdikriminim dhe integritet fizik dhe mendor.

Viktima të dhunës - janë të gjithë individët, grupet e individëve apo familjet, të cilat janë viktima dhe/ose viktima të mundshme të dhunës, përfshirë dhunën në familje ose abuzimet, sipas legjislacionit në fuqi.2 (Ligji Nr. 121/2016, "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Në Republikën e Shqipërisë")

Viktimë e trafikimit - është personi fizik që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore, sipas përkufizimit të shkronjës "e", të nenit 4, të ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore". (Ligji Nr. 121/2016, "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Në Republikën e Shqipërisë")

Viktimë e mundshme trafikimi - është personi, për të cilin/të cilën, agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikim fillestar, bazuar në treguesit/indikatorët/dritën e rrethanave të veçanta të rasteve, në të cilën, të paktën tre ose më shumë elementë përbëjnë dyshimin e arsyeshëm se personi mund të jetë trafikuar. (Dokumenti i Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit).

⁹ MSHMS & UNDP. 2020. Çfare duhet te dime per dhunen seksuale dhe ate me baze gjinore

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje - është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje. (Ligji shqiptar "Për Masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" ndryshuar në vitin 2018)

Koordinator vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, - punonjësi pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, përgjegjës për referimin e menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave (Vendim Nr. 327, datë 2.06.2021)¹⁰

Menaxhim i rastit të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, - veprimtaria efektive që siguron ndihmën e mbështetjen e personave të dhunuar në marrëdhëniet familjare, me qëllim mbrojtjen, garantimin e të drejtave dhe rehabilitimin e tyre (Vendim Nr. 327, datë 2.06.2021)

Shërbime të kujdesit shoqëror - është një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. (Ligji Nr. 121/2016, "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Në Republikën e Shqipërisë")

Shporta e shërbimeve, - tërësia e shërbimeve që ofrohen nga njësi vendore për mbrojtjen urgjente dhe afatgjatë të viktimës (Vendim Nr. 327, datë 2.06.2021)

Ekipi teknik ndërdisiplinor - përbëhet nga përfaqësues teknikë të institucioneve që janë të përfaqësuar në komitetin drejtues, përfaqësues nga prefektura përkatëse, nga Shërbimi i Provës, nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe nëpunës vendorë të barazisë gjinore, pranë asaj njësie të vetëqeverisjes vendore, si dhe nga profesionistë të lirë nga fushat sociale, të psikologjisë, avokatisë, të shërbimit shëndetësor, të mjekësisë ligjore, përmbarrimit dhe Shërbimit të Ndihmës Juridike Falas. (Vendim Nr. 327, datë 2.06.2021)

Grupi teknik ndërsektorial - ka në përbërje përfaqësues të strukturave të policisë, strukturave të shërbimeve sociale, përfaqësues të strukturave arsimore, shëndetësore, të drejtësisë, të organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo specialist tjetër që ka njohuri për situatën e fëmijës ose që mund të kontribuojë në marrjen apo zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijës, të cilët janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet e grupit teknik ndërsektorial. (_Ligj_18_2017_23.02.2017_ Për_të_drejtat_dhe_mbrojtjen_e_fëmijës)

¹⁰ Vendim Nr. 327, datë 2.06.2021 Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës)

IV. SHËRBIMET RIINTEGRUESE PËR TË MBIJETUARAT E DHUNËS ME BAZË GJINORE

- Strehimi
- Mbështetja psikologjike dhe sociale
- Shërbimi shëndetësor dhe shëndetit mendor
- Ndihma juridike
- Edukimi dhe trajnimi
- Punësimi dhe fuqizimi ekonomik
- Ndihma dhe shërbimet për fëmijët e viktimave të DHBGJ
- Informimi dhe referimi

STREHIMI

Përshkrimi i shërbimit

Viktimat e dhunës në familje dhe të formave të tjera të dhunës dhe trafikimit të qenieve njerëzore kanë të drejtë për një sërë përfitimesh, një ndër këto është edhe ai i strehimit, siç parashikohet në Ligjin e 2016-ës për Shërbimet e Kujdesit Social; prioritet për banesat sociale bazuar në Ligjin e 2018 për Strehimin Social¹¹.

Funksionimi i "strehimit" si një shërbim mbështetës i specializuar në Shqipëri bazohet në një sërë standardesh kombëtare. Ekzistojnë standarde të miratuara për: strehëzat e viktimave të dhunës në familje që ofrojnë shërbim afatgjatë¹², strehëza për viktimat/viktima të mundshme të trafikimit¹³, strehëza afatshkurtëra (emergjente) për viktimat e dhunës në familje¹⁴; si dhe për qendrat e emergjencës së krizave për viktimat e dhunës seksuale.

11 Ligji i nr. 22/2018 "Për Strehimin Social" është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 79, datë 30 maj 2018

12 . DCM No. 505 dated 13.07.2011 "On adopting social care service standards for domestic violence victims in public and non-public residential centers", and Regulation No. 13 dated 17.12.2012 "On the implementation of social care service standards for domestic violence victims in public and non-public residential centers".

13 DCM No. 195, dated 11.04.2007 "On adopting social care services standards in residential centers for trafficked persons or persons at risk of being trafficked"

14 Instruction No. 774 dated 15.11.2019 "On adopting minimum social care service standards for gender based violence and domestic violence victims/survivors in public and nonpublic emergency (short term) residential centers (emergency shelters)".

Qendrat rezidenciale mundësojnë strehimin në to të të mbijetuarave të dhunës për një periudhë të shkurtër, siç janë qendrat pritëse, ose edhe për një kohë më të gjatë, që janë qendrat riintegruese, të cilat ofrojnë mbështetje për riintegrimin afatgjatë. Përveç qendrave rezidenciale shtetërore që janë në një numër të limituar dhe me kapacitete të munguara në pjesën më të madhe të tyre, organizatat jofitimprurëse si "Të Ndryshëm & Të Barabartë", "Vatra" dhe "Tjetër Vizion", etj., aplikojnë edhe mundësitë e strehimit dhe ofrimit të shërbimeve të nevojshme në apartamente të cilat janë: apartamente gjysmë të pavarura dhe apartamente me pavarësi të plotë¹⁵. Ligji Nr. 22/2018 "Për strehimin social", vendosi rregulla, procedura dhe modalitete administrative për planifikimin, pajisjen, shpërndarjen dhe menaxhimin e strehimit për grupet sociale në nevojë për strehim. Nga programi i banesave të specializuara i cili rregullohet për herë të parë nëpërmjet dispozitave të këtij projektligji parashikohet të përfitojnë shtresat vulnerabël ku përfshihen edhe viktimat e trafikimit, viktimat e dhunës në familje dhe vajzat nëna. Sipas Ligjit nr. 22/2018 për strehimin social në programet sociale të strehimit përfshihen: a) programi i banesave sociale me qira; b) programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri; c) programi i banesave me kosto të ulët, në vijim; ç) programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi; d) programi për krijimin e banesave të përkohshme; dh) programi i banesave të specializuara. Në Nenin 16 të ligjit, "Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve", përcaktohet se u jepet përparësi të mbijetuarave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit/viktimave të mundshme të trafikimit.

Sfidat

- Përfitimi i viktimave të dhunës/trafikimit nga e drejta e strehimit social apo bonuset e qirave mbetet i ulët. Deri në vitin 2018, asnjë prej tyre nuk kishte përfituar ndonjëherë nga skemat e strehimit social.¹⁶
- Shërbimet e strehimit në pjesën më të madhe të rasteve ofrohen nga organizatat jo-qeveritare, ku përpos të qenit të vetmet entitete që ofrojnë shërbime të caktuara, këto entitete hasin në problematika si mbështetja financiare e vazhdueshme dhe e qëndrueshme¹⁷.
- Programet sociale të strehimit krijojnë paqartësi për gratë dhe vajzat VT/VMT, dhe numri i përfituesve është relativisht i ulët (MB & IOM, 2016, f.19, 20).¹⁸ Sipas MSHMS dhe UNDP (2019), procedurat nga aplikimi deri te miratimi i programeve të strehimit social janë relativisht të gjata, të cilat zgjasin disa muaj duke krijuar vështirësi në ofrimin e shërbimeve.
- Në disa bashki mungojnë alternativat e strehimit afatgjatë për viktimat e dhunës në familje.
- Shqetësimet e shprehura nga pjesëmarrësit në studim lidhur me strehimin

15 Te Ndryshëm dhe te Barabarte. Studimi mbi "Modelin e riintegrit për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore"

16 Avokati I Popullit. (2020). raport alternativ mbi zbatimin e konventës CEDAW në Shqipëri 2016 - 2020

17 Te Ndryshëm dhe te Barabarte. Studimi mbi "Modelin e riintegrit për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore"

18 MB & IOM. (2016). Plan veprimi Për riintegrimin socioekonomik të grave dhe vajzave viktimat të trafikimit të personave.

janë pamundësia për të paguar qeranë, paqartësia lidhur me sa do të zgjasë mbështetja për qeranë e shtëpisë, largësia nga vendi i punës. Informacioni për strehimin social ishte i pakët dhe se ka individë nga institucione që nuk i njohin dhe nuk dinë t'i prezantojnë shërbimet e strehimit social¹⁹.

- Shumë viktimat të trafikimit nuk kanë shtëpi të tyre, çka do të thotë se pas trafikimit kthehen pranë familjes, ose për të jetuar me bashkëshortin/en ose me prindërit. Megjithatë, kjo mundësi nuk është e garantuar dhe shumë viktimat nuk mund të kthehen në shtëpi, pasi familjet nuk i pranojnë pas trafikimit.

Nevoja për strehim dhe akomodim

Viktimat që kthehen në shtëpi me fëmijë ose viktimat që lindin si rrjedhojë e trafikimit mund të mos jenë të mirëpritura pranë familjeve të tyre, çka i detyron të qëndrojnë vetëm dhe të gjejnë e të paguajnë akomodimin vetë. Gjetja e një strehimi të përshtatshëm për një nënë me fëmijë është edhe më e vështirë dhe ka më pak alternativa²⁰.

Ishte e pamundur të kthehesha dhe të jetoja me familjen time. Ata nuk e dinë që jam shtatzënë. Më fajësojnë mua për atë që më ndodhi... nëse e zbulojnë se jam shtatzënë, do të marr fund (viktimitë trafikimi femër, që ka mbetur shtatzënë gjatë trafikimit).²¹

Viktimat jetojnë në banesa me qera dhe nuk kanë pronësi mbi banesat. Një nga problemet e hasura për strehimin është mungesa e banesave të lira që mund të blihen apo të merren me qera. Sipas një prej informuesve, ***"Njerëzit nuk i shesin apo i japin me qera shtëpitë sepse ndërtimi i rrugës e ka bërë të kollajshme ardhjen në Kukës dhe njerëzit i mbajnë shtëpitë"***²²

Praktikat e mira

Me mbështetjen e OJF-ve, janë ngritur qendra pritëse për viktimat e DHBGJ-së dhe strehëza emergjente për ofrimin e shërbimeve të strehimit dhe të tjera për gratë dhe vajzat e dhunuara. Një pjesë e tyre arrijnë të ofrojnë edhe shërbime afatgjatë për viktimat e dhunës (p.sh. pagesa e qerasë pas daljes nga qendra)²³

19 Te Ndryshem dhe te Barabarte. Studimi mbi "Mundësitë për të zhvilluar plane të suksesshme riintegrimi të viktimave të dhunës me bazë gjinore në bashkitë Kukës, Dibër, Korçë dhe Berat"

20 Surtees, R., M. Meshi, S. Tanellari, A. Lila, O. Hinaj and B. Meçaj (2022) Mbështetja e fëmijëve të viktimave të trafikimit. Udhëzues riintegrimi për profesionistët. Tiranë: Të Ndryshëm & Të Barabartë dhe Ëashington, D.C.: NEXUS Institute.

21 Surtees, R., M. Meshi, S. Tanellari, A. Lila, O. Hinaj and B. Meçaj (2022) Mbështetja e fëmijëve të viktimave të trafikimit. Udhëzues riintegrimi për profesionistët. Tiranë: Të Ndryshëm & Të Barabartë dhe Ëashington, D.C.: NEXUS Institute.

22 Te Ndryshem dhe te Barabarte. Studimi mbi "Mundësitë për të zhvilluar plane të suksesshme riintegrimi të viktimave të dhunës me bazë gjinore në bashkitë Kukës, Dibër, Korçë dhe Berat"

23 Avokati i Popullit. (2020). Raport alternativ mbi zbatimin e konventës CEDAW në Shqipëri 2016 - 2020

Ka dhe disa bashki që kanë ndërmarrë iniciativa për t'i garantuar viktimave të dhunës përfitimin nga bonusi i qerases sociale për strehim duke lehtësuar procedurën e aplikimit dhe duke asistuar viktimat e dhunës për përfitimin e saj.

Eda, pas situatës së dhunës ekstreme të ushtruar nga bashkëshorti, dhe për të shpëtuar prej tij, merr të dy fëmijët e saj dhe largohet nga shtëpia. Ajo gjendet në situatë rruge dhe pas kontaktit me një institucion referohet pranë organizatës. Menjëherë i ofrohet akomodim bashkë me fëmijët e saj. Organizata e mbështeti financiarisht për pagesën e qirasë për disa muaj por në të njëjtën kohë u mbështet për përgatitjen e dokumentave për përfitimin e bonusit të qerasë të ofruar nga Bashkia. Përfituesja u shpall fituese dhe përfitoi një vit qira nga bashkia. Me kalimin e një viti, përfituesja arriti të mbledhë vetë dokumentat që i nevojiteshin për riaplikim për bonus të ri dhe u shpall sërish fituese. Tani jeton e pavarur së bashku me dy fëmijët e saj në apartament me qira.

Përgjatë gjithë kësaj periudhe Eda së bashku me fëmijët u mbështetën me të gjitha shërbimet e tjera për të cilat kishin nevojë për rikuperimin dhe fuqizimin e tyre për të jetuar më pas të pavarura.

Ky shëmbull tregon rëndësinë që kanë programet e strehimit pranë çdo Bashkie si një ndihmë e menjëhershme për çdo rast të dhunës në familje, pas daljes nga dhuna të nënës dhe fëmijëve të saj.

Rekomandime

- Hartimi i legjislacionit në fushën e strehimit social duhet të shoqërohet me rritjen e buxhetit si dhe me mbështetjen që duhet të japë qeverisja qendrore ndaj organeve të qeverisjes vendore me projekte sociale të strehimit.
- Bashkitë të rrisin shpenzimet e planifikuara në lidhje me përfshirjen në programet e strehimit social të viktimave të DHBGJ-së dhe viktimave të trafikimit.
- Ofrimi i ndihmës së drejtpërdrejtë në plotësimin e dokumentacionit për bonuset e qerasë/ strehimit social.

MBËSHTETJA PSIKOLOGJIKE DHE SOCIALE

Përshkrimi i shërbimit

Ofrimi i shërbimeve cilësore të kujdesit shoqëror përbën një nga komponentët thelbësorë të një reagimi shumë-sektorial të koordinuar kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Shërbimet e kujdesit shoqëror përfshijnë një gamë të gjerë shërbimesh, që janë tepër të rëndësishme për mbështetjen e të drejtave,

sigurisë dhe mirëqenies së grave dhe vajzave, si dhe të cilitdo individ tjetër në familje, të cilët kanë përjetuar dhunë, duke përfshirë këtu informimin në situatë krize, linjat telefonike të ndihmës, strehim të sigurt, këshillim psiko-social, informim dhe këshillim mbi të drejtat e tyre, e të tjera.

Shërbimet e kujdesit shoqëror janë të domosdoshme për të ndihmuar rimëkëmbjen e grave nga dhuna, fuqizimin e tyre, për të parandaluar përsëritjen e dhunës dhe në disa raste, për të punuar me pjesë të caktuara të shoqërisë ose të komunitetit për të ndryshuar qëndrimet dhe perceptimet për dhunën. Ato përfshijnë, por nuk kufizohen tek: ofrimi i këshillimit psikosocial, mbështetja financiare, informacioni në rast krize, strehimi i sigurt, shërbimet ligjore dhe avokuese, mbështetja në gjetjen e strehimit dhe të punësimit etj. Për gratë dhe vajzat që kanë përjetuar dhunë etj.

Shërbimet e kujdesit shoqëror për viktimat e dhunës përfshijnë shërbime të ofruara nga, ose të financuara nga qeveria ose shërbime të ofruara nga shoqëria civile dhe aktorë të komunitetit, përfshirë organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat me bazë fetare.

Sipas ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", bashkia është institucioni përgjegjës për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë (neni 54, ligji 139/2015).

Sipas ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë": "Shërbime të kujdesit shoqëror" janë një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. VKM nr. 518 datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar" percakton se shërbimet e kujdesit shoqëror organizohen në:

- Shërbime parashoqërore: informimi dhe këshillimi, ndërhyrja e hershme, këshillimi on-line;
- Shërbime në komunitet: shërbimi në familje, alternativ, multifunksional, ditor dhe gjysmëditor, i emergjencës 72-orëshe, i strehimit të mbrojtur për të pastrehët.
- Shërbime rezidenciale afatgjata dhe shërbime të specializuara.

Ligji nr. 9669, datë 18. 12. 2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" i ndryshuar parashikon në nenin 6, pika i) parashikon koordinimin dhe monitorimin e ngritjes dhe të funksionimit të shërbimeve të perkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, që do të ofrohen pranë njësive të vetëqeverisjes vendore.

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV)²⁴ për punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror mundësojnë një përshkrim të qartë dhe të hollësishëm të veprimeve të përditshme të ofrueseve dhe ofruesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të quajtur më poshtë si punonjëse dhe punonjës të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat/cilët mund të ofrojnë ndihmë dhe shërbime për viktimat e DHF/ DHBGJ.

Të gjitha gratë që janë duke përjetuar ose kanë përjetuar abuzim në familje kanë nevojë për mbështetje psikologjike, emocionale. Është shumë e rëndësishme që të gjitha gratë të dëgjohen me respekt dhe pa u gjykuar kur zgjedhin të flasin për përvojat e tyre. Këshillimi i specializuar psiko-social mund të përmirësojë shumë mirëqenien emocionale dhe shëndetësore për viktimat, rritjen dhe zhvillimin e kapacitetit të brendshëm për përballim e situatave, i cili, më pas çon rrjedhimisht në përmirësimin e aksesit të tyre në arsim dhe punësim.

Për ofrimin e shërbime psikologjike, punonjësi i policisë dhe KVDHF duhet të kontaktojë me psikologët e bashkisë, Linjën Kombëtare të Këshillimit për Gra dhe Vajza në numrin pa pagesë 116117, anëtarët e MKR-së të specializuar në ofrimin e një shërbimi të tillë, organizata të tjera të licensuara për ofrimin e shërbimit psiko-social falas, ose me Urdhërin e Psikologut, Urdhërin e Punonjësit Social për të siguruar shërbimin e kërkuar.

Një profesionist psikolog duhet të jetë pjesë e konsultimeve për hartimin e Planit të Riintegritimit dhe e zbatimit të këtij plani. Seancat e këshillimit duhet të jenë specifike për secilin rast në përputhje me objektivat e përcaktuara në plan. Vendosja e qëllimit për seancat e këshillimit realizohet me mbështetjen e të dy palëve. Qëllimet që drejtojnë seancat e këshillimit psikologjik konsistojnë kryesisht në: stabilizimin gjendjes emocionale; teknikat për rritjen e vetëbesimit / vetëvlerësimit, trajtimin e episodeve traumatike të jetës dhe njohja e emocioneve që përshkojnë këto episode; njohja dhe ndërgjegjësimi mbi ciklin e dhunës; vënien në dukje të pikave të forta; krijimi i marrëdhënieve të shëndetshme, marrëdhëniet ndërpersonale; planet për të ardhmen; aftësitë praktike për jetën; çështjet e komunikimit; marrja e vendimeve / orientimi drejt vendimmarrjes; qëndrueshmëria në marrëdhëniet e punës (rritja e përgjegjësisë, korrektësisë, kuptimit të nevojës për punë), etj.

Sfidat

- Në disa nga bashkitë janë organizatat jofitimprurëse ato që kanë plotësuar nevojat për shërbime të bashkive për adresimin e dhunës në familje. Këto shërbime karakterizohen nga të qëniet jo të qëndrueshme për shkak të mungesës së fondeve dhe ndryshimit të prioriteteve sipas orientimeve të donatorëve dhe që shtrihen vetëm në zona të caktuara.

²⁴ Urdhër Nr. 100, datë 21.2.2020 Për procedurat standarde të veprimit (psv) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore nga punonjëset/ punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të mekanizmave të koordinuar të referimit

- Profesionistët shikojnë si një nga sfidat më të mëdha mungesën e shërbimeve sociale në nivel lokal. Mungesa e shërbimeve mendohet që në disa raste mund të jetë dhe arsyeja sepse gratë e dhunuar nuk raportojnë rastet e dhunës pasi nuk shikojnë mënyra alternative mbështetëse për të dal nga situata në të cilën ndodhen.
- Mbështetja psikologjike dhe sociale për viktimat dobësohet nga mungesa dhe mbingarkesa e stafit të shërbimit social në bashki²⁵
- Të mbijetuarat e dhunës në familje nuk kanë informacion për rëndësinë që ka mbështetja psikologjike dhe emocionale. Sipas një studimi²⁶ të vitit 2021 në 98% të rasteve, gratë dhe fëmijët e tyre kishin nevojë për mbështetje psikologjike dhe sociale, por jo në të gjitha rastet këshilluesi i kishte informuar se si ta merrnin një mbështetje të tillë.
- Profesionistët e institucioneve jo gjithmonë marrin në konsideratë ndikimin e normave dhe vlerave kulturore që mbartin viktimat dhe si rrjedhojë marrja e shërbimeve pëson ngecje, nuk ofrohet në përputhje me ritmin e viktimave të dhunës dhe qëllimeve të paracaktuara.

Praktikat e mira

Bashkia Tiranë²⁷ raporton që menaxhojnë dhe ndihmojnë rastet e trafikimit dhe dhunës në familje, duke i siguruar atyre mbrojtje, informim, strehim, këshillim psikologjik dhe ligjor, nëpërmjet koordinimit me të gjithë aktorët e shoqërisë civile që janë të angazhuar në luftën kundër dhunës me bazë gjinore, në interes të viktimave. Bashkia Tiranë financon 6 qendra komunitare ku funksion kryesor i tyre është këshillimi dhe trajtimi psikologjik i rasteve të identifikuara në nevojë, ku frekuentuese janë edhe gra, të cilat mund të kenë qenë të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore. Bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse, cilësohet si thelbësor në menaxhimin e ndihmës dhe riintegrimin të rasteve të trafikimit dhe dhunës me bazë gjinore. Në varësi të rasteve Bashkia Tiranë ka një bashkëpunim me këto organizata si për shembull me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare, organizatën Të Ndryshëm & të Barabartë, Nismën Arsis, Plan & Go, etj. Bashkia Tiranë ka krijuar dhe rrjetin e koordinatorëve vendor të dhunës në familje që mblidhen në mënyrë periodike dhe diskutojnë për rastet, sfidat, nevojat, praktikat e mira. Bashkia Tiranë bashkëpunon me çdo bashki me qëllim ndjekjen dhe monitorimin e rasteve edhe kur zhvendosen apo kthehen në qytetet e tyre të origjinës.

S. viktimë e dhunës nga partneri referohet pranë organizatës. Ajo është nënë e më shumë se 3 fëmijëve dhe është në pritje të një fëmije tjetër, gjithashtu. Disa nga fëmijët janë konceptuar dhe lindur si rrjedhojë e dhunës seksuale. Partneri ndodhet në burg pas denoncimit të dhunës. Kur u referua fillimisht S. ishte e ndërgjegjshme se ishte dhunuar fizikisht dhe seksualisht por kishte ende ndjenja për partnerin dhe shpresonte se ai do ndryshonte pasi të dilte nga burgu dhe të jetonin së bashku. Ajo shfaqte nivele të larta të stresit, ankth dhe ishte hipervigjilente ndaj situatave. Pas realizimit të seancave të këshillimit me psikologun dhe menaxheren e rastit, ajo u njoh me ciklin e dhunës dhe u ndërgjegjësua për situatën në të cilën gjendej. Si rrjedhojë, pas një periudhe kohe, ndaloi kontaktet me parterin dhe familjen e tij dhe mori iniciativën të strehohet në një shtëpi me qira së bashku me fëmijët. Nivelet e akthit dhe të stresit ishin më të reduktuara dhe gjeti forcë dhe motiv të fëmijët e saj, të cilët janë pika më e fortë.

Avokatja e organizatës në bashkëpunim me punonjësën për mbrotjen e fëmijës bënë të mundur rregjistrimin e fëmijëve në gjendjen civile dhe finalizimin e dokumentave për pajisje me Urdhër Mbrotje.

Seancat e këshillimit me psikologun vazhdojnë ende....

Rekomandime

- Hartëzimi i shërbimeve në nivel lokal dhe referimi i të mbijetuarave të dhunës në familje në shërbimet sociale bazuar në nevojat e identifikuara;
- Identifikimin e burimeve të ndihmës psikologjike dhe orientimin dhe mbështetjen për të marrë shërbimin e vlerësimit psikologjik dhe ndihmës psikologjike falas²⁸;
- Vlerësimi i nevojave të mbijetuarave të dhunës në familje, fëmijëve dhe familjeve të tyre dhe planifikimi për ngritjen e shërbimeve dhe financimin e tyre në planet sociale vendore
-
- Ndjekjen e të mbijetuarave të dhunës në familje gjatë aksesit të shërbimeve sociale dhe psikologjike për tu siguruar që ata përfitojnë dhe kanë progres në adresimin e nevojave të tyre
- Ngritja e kapaciteve të punonjësve të institucioneve për njohjen e ndikimit të kulturës (vlerat, normat, ritualet, gjuhën, traditat) që viktimat sjellin dhe përshtatja e këtyre fenomeneve në raport me fuqizimin e tyre
- Ofrimi i shërbimeve psiko-social përmes profesionistëve të qendrave komunitare

SHËRBIMI SHËNDETËSOR DHE SHËNDETIT MENDOR

Përshkrimi i shërbimit

Sistemi shëndetësor dhe punonjëset e punonjësit e shërbimeve shëndetësore luajnë një rol të rëndësishëm, për sa i përket identifikimit, vlerësimit, trajtimit, ndërhyrjes në situatë krize, dokumentimit, referimit dhe ndjekjes së rasteve të DHF-së/DHBGJ-së. Gratë dhe vajzat shpesh kërkojnë shërbime shëndetësore për dëmtimet e tyre edhe nëse nuk e tregojnë dhunën apo abuzimin e lidhur me këto dëmtime.

Nëse nga dhuna e ushtruar e mbijetuara e DHBGJ ka dëmtime në shëndet, duhet patjetër të drejtohet në njësinë vendore të kujdesit shëndetësor apo në spitalin më të afërt për të marrë shërbimet shëndetësore që i nevojiten. Në njësitë vendore të kujdesit shëndetësor ose në spitalin më të afërt, rasti kryen vizitën, merr trajtimin e nevojshëm mjekësor, mbështetje psikologjike dhe pajiset me raportin mjekësor, i cili përbën një provë të rëndësishme gjatë procesit të kërkimit të lëshimit të urdhërave të mbrojtjes.

Vlerësimi i shëndetit fizik, duhet të bëhet pjesë e vlerësimit për çdo rast. Ai duhet të bëhet nga personeli mjekësor dhe bazuar në këtë vlerësim kryen vizitat, analizat dhe trajtimet e nevojshme mjekësore. Ofruesit e shërbimeve shëndetësore është e rëndësishme të jenë të vetëdijshëm që problemet shëndetësore të një gruaje mund të shkaktohen ose të përkeqësohen nga dhuna.

Ligji nr. 9669, datë 18. 12. 2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" i ndryshuar parashikon në nenin 7 që ministria përgjegjëse për shëndetësinë siguron ndihmën mjekësore në familje, në shërbimet e urgjencës, të mjekut të familjes dhe në qendrat shëndetësore pranë njësive të vetëqeverisjes vendore: a) për të ofruar në çdo kohë ndihmë mjekësore, sociale e psikologjike për viktimat e dhunës në familje; b) për të bërë në çdo kohë ekzaminimet e nevojshme në institucionet shëndetësore publike përkatëse; c) për të evidentuar rastet e dhunës në familje në dokumentacionin përkatës mjekësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë; ç) për të pajisur edhe viktimën me raportin mjekësor përkatës; d) për të referuar dhe orientuar viktimën pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.

Kujdesi shëndetësor për gratë dhe shëndeti riprodhues përbëjnë një nga kapitujt kryesorë të Paketës Bazë të Kujdesit Shëndetësor Parësor²⁹, rishikuar dhe miratuar me VKM Nr. 101 datë 04.02.2015. Kjo paketë ofrohet nga shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor të shtrira në të gjithë vendin. Kujdesi shëndetësor i integruar për gratë në qendrat shëndetësore mbulon aspektet përkatëse parandaluese, promovuese, kurative dhe rehabilituese. Në këto shërbime përfshihet edhe menaxhimi i dhunës dhe abuzimit me gruan, dhunës në familje. Kjo paketë parashikon që mjeku dhe infermierja e familjes duhet të jenë të aftë të identifikojnë

²⁹ www.shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2018/02/Paketa_e_rishikuar_e_miratuar.pdf

dhe referojnë rastet e dhunës në familje në institucionet përkatse.

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV)³⁰ për punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, përshkruajnë tërësinë e veprimeve dhe hapave thelbësorë që duhet të planifikohen, koordinohen, zbatohen, monitorohen dhe vlerësohen rregullisht, për ofrimin e kujdesit dhe ndihmës së duhur në situata të dhunës në familje dhe/ose dhunës me bazë gjinore.

Shumë gra që janë subjekt i dhunës nga partneri intim ose i dhunës seksuale, do të kenë si pasojë probleme emocionale ose të shëndetit mendor. Ka të ngjarë që, pasi të kalojë kohë nga ushtrimi i dhunës, përfshirë abuzimin seksual apo situata të ngjashme, këto probleme emocionale do të përmirësohen. Shumica e grave shërohen. Ka mënyra specifike se si ofruesit e shërbimeve shëndetësore mund të ndihmojnë gratë përmes teknikave të ndryshme që të zvogëlojnë stresin dhe të nxisin shërimin. Megjithatë, disa gra mund të vuajnë më shumë se të tjerat. Është e rëndësishme që punonjëset dhe punonjësit e shëndetësisë të jenë në gjendje t'i njohin këto gra dhe t'i ndihmojnë ato që të marrin kujdesin e nevojshëm³¹.

Sfidat

- Bashkitë raportojnë mungesë të shërbimeve të specializuara për menaxhimin dhe trajtimin e të mbijetuarave të DHF që vuajnë ose janë të diagnostikuar me probleme të shëndetit mendor. Trajtimi i të mbijetuarave të DHF dhe autorëve të DHF-ve që vuajnë me probleme të shëndetit mendor është një nga sfidat më të mëdha, duke qenë se shpesh akomodohen dhe trajtohen përkohësisht në spitalet rajonale dhe më pas dalin për shkak të mungesës së një qendre të specializuar në nivel rajonal ose kombëtar duke përfunduar përsëri në rrethin vicioz të DHF ose duke u shndërruar në viktime të mundshme të trafikimit në disa raste.³²
- Në nivel vendor mungojnë gjerësisht shërbimet e specializuara për personat me probleme të shëndetit mendor, të mbijetuarat e dhunës shërbimet e këshillimit për burrat dhe djemtë si autorë të dhunës në familje, si dhe shërbime të tjera mbështetëse për familjet e dhunuara.
- Vazhdon që të raportohet mungesa e identifikimit të rasteve të dhunës në familje nga punonjësit e shëndetësisë. Punonjësit e shëndetësisë përbëjnë një hallkë të rëndësishme në zinxhirin e gjithë aktorëve. Mungesa e përfshirjes së këtyre aktorëve ndikon në mos identifikimin e hershëm dhe mos adresimin e rasteve të dhunës në familje.

30 Urdhër Nr. 101, datë 21.2.2020 Për miratimin e procedurave standarde të veprimit (PSV) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore nga punonjëset/punonjësit e shërbimeve shëndetësore, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të mekanizmit të koordinuar të referimit

31 Urdhër Nr. 101, datë 21.2.2020 Për miratimin e procedurave standarde të veprimit (PSV) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore nga punonjëset/punonjësit e shërbimeve shëndetësore, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të mekanizmit të koordinuar të referimit

32 UNDP, UN Women dhe UNFPA (2019). Analiza e Funkcionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje në Nivel Vendor në Shqipëri

- Ka një stigmë në popullatë për të pranuar problemet e shëndetit mendor dhe për të kërkuar shërbime mbështetëse.
- Studimi "Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri" raporton që shumë më pak gra kanë kërkuar ndihmë nga rrjetet zyrtare të tilla si, policia (4,4%), avokatët (3,4%), **mjekët/punonjësit e shëndetësisë (3,1%)**, gjyqtarët (2,8%), ndonjë agjenci e shërbimeve sociale (1,6%), dhe nga ndonjë strehë grash dhe vajzash (0,4%)³³.
- Mungesa e besimit të viktimave për marrjen e kujdesit shëndetësor falas në rast se nuk janë të shoqëruar nga një punonjës institucioni.
- Vështirësi për të menaxhuar dhe ndihmuar personat që kanë probleme të shëndetit mendor duke qenë se mungojnë shërbimet mbështetëse për to, si dhe vështirësi për të mbajtur vendin e punës kur integrohen në tregun e punës.

Shpeshherë kërkimi i ndihmës në sektorin shëndetësor vonon ose neglizhohet për shkak të mosbesimit nga viktimat se nuk do të mund ta përfitojë shërbimin shëndetësor falas dhe në mënyrë të barabartë me të tjerët për shkak të situatës në familje dhe kushteve të vështira ekonomike. Në vazhdim të rastit të përshkuar më lart, fëmijët nuk kishin marrë asnjë shërbim shëndetësor dhe nuk ishin pajisur me vaksinat përkatëse dhe si pasojë nuk kanë mundur as të jenë pjesë e sistemit arsimor. Mjekja e organizatës në bashkëpunim me punonjësin për mbrotjen e fëmijës informuan nënën për të drejtat e saj dhe të fëmijëve për kujdes shëndetësor dhe e shoqëruan në qendrën shëndetësore të zonës ku banonte për marrjen e shërbimeve të nevojshme. Pasi rasti njohu sistemin shëndetësor dhe krijoi besimin te ky sistem ajo vazhdon të marrë të gjithë shërbimet shëndetësore në mënyrë të pavarur për veten dhe fëmijët.

Praktikat e mira

Shërbimet shëndetësore dhe të shëndetit mendor janë një domosdoshmëri për të mbijetuarat e DHBGJ por jo gjithmonë mbulohen nga institucionet shëndetësore, shpesh OJF të ndryshme plotësojnë këto nevoja duke ofruar edhe një akses me të lehtë për përfituesit. Fondacioni Kenedi në qytetin e Korçës informon se ka një klinikë që ndihmon me shërim plagësh, mjekime, fizioterapi. Korça ka një qendër komunitare të shëndetit mendor frekuentimi i të cilës ka ardhur në rritje. Studimi raporton se situata familjare rëndohet shumë pavarësisht ndihmës që i jepet të mbijetuarës në rastet kur në familjen e ngushtë ka një person me probleme të shëndetit mendor. Është shumë e rëndësishme që edhe anëtarët e tjerë të familjes me të cilët jeton e mbijetuara të mbështeten duke zvogëluar rrisqet nga të cilat mund të kërcënohet e mbijetuara³⁴.

Rekomandime

- Advokimi, ndërgjegjësimi dhe përmirësimi i njohurive mbi dhunën në

familje, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën ndaj grave e vajzave, si dhe shërbimet e MKR-ve me objektiv profesionistët që trajtojnë këto forma dhune (policia, qendrat shëndetësore, shkollat, zyrat e punësimit dhe media, etj) për parandalimin dhe adresimin e tyre.

- Punonjësit e shëndetësisë duhet të rrisin kapacitete e tyre që njohin faktorët e rrezikut, shenjat, problemet ose kushtet që paraqesin, duke përfshirë modelet e sjelljes shtrënguese ose kontrolluese të lidhura me abuzimin në familje dhe të lehtësojnë procesin e ndarjes së informacionit nga e mbijetuara e dhunës në familje.
- Ngritja e shërbimeve të shëndetit mendor lehtësisht të aksesueshme pranë qendrave komunitare në çdo bashki.
- Marrja e masave administrative ndaj punonjësve shëndetësor që nuk repsektojnë detyrimin ligjor që përcakton ligji për identifikimin, trajtimin dhe raportimin e rasteve të DHBGJ.

NDIHMJA JURIDIKE

Përshkrimi i shërbimit

Shumë viktimat ka të ngjarë të kenë njohuri të kufizuara në lidhje me të drejtat e tyre dhe gamën e mundësive që janë në dispozicion për to. Informacioni i saktë dhe në kohë mbi çështje të tilla si zgjidhja e martesës/ligjet e martesës, kujdestaria e fëmijëve, statusi i migracionit dhe ndihma për gjetjen e përgjigjeve të drejtësisë dhe policisë janë të rëndësishme për mbrojtjen e sigurisë sidomos të grave dhe vajzave.

Vitet e fundit, në kuadër edhe të reformës në drejtësi ka një përmirësim të legjislacionit edhe në drejtim të rritjes së aksesit në drejtësi për kategoritë në nevojë, përfshirë edhe viktimat e dhunës, viktimat e trafikimit dhe në tërësi për viktimat e veprës penale. Si akte më të rëndësishme ligjore në këtë drejtim përmendimin amendimet e Kodi i Procedurës Penale (ndryshimet me ligjin nr. 35/2017) dhe ligji i ri nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"³⁵.

Ligji nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" ka parashikuar se ndër kategoritë e veçanta që përfitojnë nga shërbimet ligjore falas pavarësisht nëse e përmbushin apo jo kriterin e pamundësisë ekonomike janë edhe viktimat e trafikimit, viktimat e dhunës në familje, viktimat e abuzimit seksual, të miturit viktimat dhe në konflikt me ligjin³⁶. Ligji parashikon tre forma/lloje ndihme: Ndhmë juridike parësore; Ndhmë juridike dytësore; Përrjashtim nga taksat dhe tarifat gjyqësore. Ndhma juridike parësore ofrohet nga: Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore që janë zyra të ngritura me qëllim ofrimin e këshillimit dhe

35 Të Ndryshëm Të Barabartë, (2020). Riintegrimi i të mbijetuarave nga dhuna me bazë gjinore.

36 Neni 11 i ligjit

dhënien e orientimeve ligjore falas; Klinikat e ligjit pranë Institucioneve të arsimit të lartë që janë zyra të ngritura pranë fakulteteve me qëllim ofrimin e këshillimit dhe dhënien e orientimeve ligjore falas; Organizatat jofitimprurëse (OJF) të autorizuara që janë organizata të cilat ofrojnë shërbim ligjor falas, pas marrjes së autorizimit nga Ministri i Drejtësisë për ofrimin e këtij shërbimi.

Ndërsa pjesa më e madhe e OSHC-ve të të drejtave të grave ofrojnë shërbime të ndihmës juridike falas dhe këshillime për të mbijetuarat e DHF, vitet e fundit, OSHC të specializuara në ofrimin e ndihmës juridike kanë ofruar shërbime të ndihmës juridike parësore dhe dytësore për grupet vulnerabël të popullsisë në gjashtë qendra pilot të ngritura pranë Gjykatave të Rrethit Gjyqësor Lezhë, Durrës, Tiranë, Fier, Shkodër dhe Dibër. MKR-të në këto bashki raportojnë bashkëpunim me këto qendra për të ndihmuar të mbijetuarat e DHF me këshillim juridik, përfaqësim në gjykatë në çështjet e divorcit dhe kujdestarisë së fëmijëve³⁷

Sfidat

- Megjithë përmirësimet ligjore, aksesin në drejtësi dhe ofrimin e ndihmës juridike për viktimat e trafikimit mbetet një sfidë ende e pazgjidhur. Sistemi i ngritur nga ligji i ri Nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" edhe pse është një zhvillim i rëndësishëm, nga pikpamja praktike, nuk garanton ndihmë dhe mbrojtje ligjore efektive për viktimat e trafikimit. OJF-të e autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike do të përfitojnë nga skema shtetërore vetëm për ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe jo për ndihmën dytësore (përfaqësimin në gjykatë) për të cilën ka më shumë nevojë një viktimë trafikimi³⁸.
- Një pjesë e mirë e viktimave të dhunës me bazë gjinore (DHBGJ) nuk e kanë ditur dhe nuk e kanë përdorur ndihmën ligjore falas³⁹.
- Jo gjithmonë gratë janë të informuara për të drejtat që ato kanë dhe institucionet në të cilat duhet të drejtohen.
- Të mbijetuarat e dhunës në familje shpesh nuk kanë informacion për të drejtat që u takojnë sipas ligjit dhe për funksionimin e sistemit të urdhrave të mbrojtjes - ndonëse ligji thotë se ato duhet të marrin informacion nga autoritetet ligjzbatuese mbi statusin e tyre ligjor si viktimat, si dhe për shërbimet e ndryshme që u takojnë të marrin⁴⁰.
- Ndodh që punonjësit në fushën e drejtësisë të shfaqin qëndrime mospërfillëse dhe poshtëruese ndaj viktimave të dhunës në familje⁴¹

37 UNDP, UN Women dhe UNFPA (2019). Analiza e Funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje në Nivel Vendor në Shqipëri

38 Të Ndryshëm Të Barabartë, (2020). Riintegrimi i të mbijetuarave nga dhuna me bazë gjinore.

39 Të Ndryshëm & Të Barabartë" (2022). Studimi mbi "Mundësitë për të zhvilluar plane të suksesshme riintegrimi të viktimave të dhunës me bazë gjinore në bashkitë Kukës, Dibër, Korçë dhe Berat"

40 UNDP, 2018. Studim mbi aksesin në drejtësi në Shqipëri

41 UNDP, 2018. Studim mbi aksesin në drejtësi në Shqipëri

Praktikat e mira

Ligji „Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti“

Nga data 1 qershor 2018, ka hyrë në fuqi Ligji nr.111/2017 „Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti“. Ky ligj sanksionon procedurat për përfitimin e ndihmës juridike falas dhe të garantuar nga shteti.

Ndihma juridike jepet në tre forma kryesore:

- a) ndihmë juridike parësore;
- b) ndihmë juridike dytësore;
- c) përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore dhe përjashtim nga detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit.

Ndihma parësore ka një rëndësi të jashtëzakonshme, jo vetëm për garantimin e të drejtës për informim të qytetarit për të drejtat e tij lidhur me aksesin në shërbime publike dhe në institucionet publike, por edhe edukimin e tij me zgjidhjen e çështjeve në mënyra të tjera ndërmjetësimi paragjyqësore.

Ndihma juridike parësore mund të jepet në formën:

1. Informacion në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor,
2. Këshillim ligjor
3. Këshillimin mbi procedurat e ndërmjetësimin dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve,
4. Dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore
5. Përfaqësim përpara organeve administrative,
6. Format e tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

Ndihma dhe mbështetja e ofruar për përfitueset ka konsistuar në: hapjen e një llogarie në E- Albania dhe aplikimi për të siguruar dokumenta të ndryshme në këtë faqe; ndihmë për regjistrimin e fëmijës në gjendje civile (pajisje e certifikatës së lindjes me vulë apostile nga shteti i huaj), informim për urdhrin e mbrojtjes, ndihmën ekonomike si viktimitë dhune, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, shkeljen e urdhrin të mbrojtjes, bonusin e qerasë dhe plotësim i dokumentacionit, njohjen e vendimit gjyqësor të huaj, informim për të drejtat e viktimës në proces penal, ekzekutimin e detyrimit ushqimor, statusin e jetimit etj.

Ndihma juridike parësore jepet nga:

- a) punonjësit me trajnim të posaçëm;
- b) nga organizatat jofitimprurëse të autorizuar;
- c) nga klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.

Së pari **punonjësit me trajnim të posaçëm**, i cili është punonjësi i diplomuar nga një program i ciklit të dytë të studimeve në drejtësi, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe që i është nënshtruar një trajnimi të posaçëm të zhvilluar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me Qendrën e Trajnimit të Administratës Publike. Ky punonjës ofron ndihmë juridike parësore në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme. Edhe **organizatat jofitimprurëse të autorizuar** dhe të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi, të cilat kanë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës, ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike, mund të ofrojnë ndihmë juridike parësore.

Edhe **klinikat ligjore** pranë institucioneve të arsimit të lartë janë operatorë të rëndësishëm të ofrimit të ndihmës juridike parësore. Këto institucione duhet të sigurojnë që ndihma juridike parësore të jepet vetëm nga studentët të cilët janë trajnuar sipas trajnimeve të miratuara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas.

Informimi i përfituesve për ndihmën ligjore falas është shumë rëndësishëm pasi rrit aksesin në drejtësi dhe fuqizon viktimat.

Rasti M. (Kukës) është viktimë dhune e pajisur me urdhër mbrojtje. Ajo ka firmosur listën e të drejtave kur ka bërë kallëzim penal në Polici por nuk i janë shpjeguar të drejtat në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për të.

Për zgjidhjen e martesës ajo ka kontaktuar me një avokat privat në vendin ku është lidhur martesa të cilin e ka paguar për shërbimin e ofruar.

Pasi kishte inicuar procesin për zgjidhje martese, M. u referua në programin e organizatës "Të Ndryshëm & Të Barabartë" ku u informua nga avokatja e organizatës se për arsye se është viktimë e dhunës në familje e përfiton gjyqin për zgjidhje martese falas.

Duke qenë se ishte e pamundur që të kthehej pagesa që i kishte bërë avokatit privat (ai kishte përgatitur kërkesë padinë për zgjidhje martese), **përfituesja u ndihmua në përgatitjen e kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore (konkretisht për shpenzimet e ekspertit psikolog).**

M. nuk ishte informuar më parë për të drejtën për të patur avokat falas dhe për përjashtimin nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore. Kjo ka sjellë që viktima ka paguar për të marrë një shërbim që ofrohet falas nga shteti, ka paguar shpenzimet e transportit, taksën e padisë (3.000 lekë) duke rënduar gjendjen ekonomike të viktimës, e cila ishte edhe e papunë.

Ky shembull tregon se sa e rëndësishme është që viktimat të informohet për të drejtat që ka, përfshirë dhe asistencën ligjore falas.

Rekomandime

- Ofrimi i mbështetjes dhe aksesit të drejtpërdrejtë dhe sa më të shpejtë për viktimat e dhunës në familje përmes sigurimit të informacionit të saktë mbi ndihmën ligjore falas në mënyrë që të mënjanojnë shpenzimet dhe stresin e panevojshëm⁴².
- Shpallja e kontakteve të ndihmës ligjore falas në vende të dukshme, grumbullimi dhe analizimi i informacionit për ndihmën e referuar dhe të marrë si dhe bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile që japin ndihmë ligjore⁴³.
- Të rriten njohuritë ligjore të popullatës vecanërisht të grave dhe grupeve të tjera të marginalizuara për të rritur aksesin në shërbimet që ofrohen nga sistemi i drejtësisë.

EDUKIMI DHE TRAJNIMI

Përshkrimi i shërbimit

Edukimi dhe arsimiti është thelbësor për riintegrimin e suksesshëm të grave dhe vajzave që nuk kanë mundur ta përfundojnë arsimimin e plotë dhe janë detyruar ta ndërprejnë. Të paturit e një niveli të caktuar të arsimit është kryesisht një kusht paraprak për gjetjen e punësimit.

Edukimi është një e drejtë e njeriut dhe se aksesin e barabartë në arsim, trajnim dhe teknologji fuqizon gratë dhe vajzat. Edukimi është një nga mjetet më të rëndësishme për fuqizimin e grave me njohuritë, aftësitë dhe vetëbesimin e nevojshëm për të marrë pjesë plotësisht në procesin e zhvillimit. Për të fuqizuar vajzat dhe gratë duhen ndërmarrë hapa për të eliminuar pabarazitë midis burrave dhe grave duke zhvilluar ndërhyrjet e duhura për të përmirësuar aftësinë e grave për të fituar të ardhura përtej profesioneve tradicionale, për të arritur vetë-mbështetje ekonomike dhe për të siguruar akses të barabartë të grave në tregun e punës. Arsimiti rrit mundësitë e punësimit të grave dhe statusin socio-ekonomik. Fuqizimi i grave redukton marrëdhënien e pabarabartë të pushtetit midis grave dhe burrave, e cila është identifikuar si shkak kryesor i dhunës me bazë gjinore.

Organizatave të shoqërisë civile kanë mbështetur gratë dhe vajzat përmes klasave të edukimit dhe trajnimeve mbi aftësitë për jetën, edukimin e karrierës me qëllim

42 Të Ndryshëm & Të Barabartë” (2022). Studimi mbi “Mundësitë për të zhvilluar plane të suksesshme riintegrimi të viktimave të dhunës me bazë gjinore në bashkitë Kukës, Dibër, Korçë dhe Berat”

43 Të Ndryshëm & Të Barabartë” (2022). Studimi mbi “Mundësitë për të zhvilluar plane të suksesshme riintegrimi të viktimave të dhunës me bazë gjinore në bashkitë Kukës, Dibër, Korçë dhe Berat”

që ato të rrisin mundësitë e integritit në tregun e punës dhe të krijojnë të ardhura të qëndrueshme për veten dhe familjen. Procesi i vlerësimit të nivelit arsimor të të mbijetuarave të dhunës në familje dhe informimi që bëhet nga profesionistët mbi rëndësinë e arsimit ndihmon që gratë dhe vajzat të ndërgjegjësohen dhe të angazhohen për të ndjekur shkollën, trajnimet apo kurset e ndryshme me qëllim që të ndërtojnë një jetë të pavarur dhe të sigurtë për veten dhe fëmijët e tyre.

Sfidat

- Të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore, shpeshherë raportohen me mungesë të arsimit bazë, dhe si rrjedhojë kanë më pak mundësi për të gjetur punë.
- OJF-të raportojnë që të mbijetuarat përballen me vështirësi në gjetjen e punësimit, për shkak të nivelit të ulët arsimor.

Praktikat e mira

Organizatat jofitimprurëse si Të Ndryshëm & Të Barabartë, Tjetër Vizion dhe Vatra ndërmjetësojnë dhe lehtësojnë regjistrimin në shkollë të tyre. Këto OJF kryejnë vlerësimin paraprak të nivelit arsimor të grave dhe vajzave të mbijetuara dhe identifikojnë nevojat e tyre për arsim. Nëpërmjet bashkëpunimit me shkollat, Zyrat Arsimore apo Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe entitete të tjera përkatëse vijon të mundësohet rifillimi i arsimimit.

Rekomandime

- Të mbështeten gratë që të përfundojnë arsimin e tyre të ndërprerë në rastet që është e mundur pasi kjo do ndihmojë në gjetjen e vendit të punës është për një proces të suksesshëm të riintegritit.
- Ofrimi i trajnimeve për tema mbi barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore, të drejtat e grave dhe vajzave me qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve, grave dhe vajzave mbi normat sociale, traditat dhe rolet e pabarabarta gjinore.
- Ofrimi i mundësive për vazhdimin e kurseve profesionale për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore pavarësisht kritereve që kërkohen për ndjekjen e një niveli të caktuar arsimi. Ndjekja e kurseve profesionale të shoqërohet edhe me një program edukimi bazë me qëllim që gratë dhe vajzat të kenë mundësinë e integritit në tregun e punës në mënyrë të qëndrueshme.

PUNËSIMI DHE FUQIZIMI EKONOMIK

Përshkrimi i shërbimit

Vajzat dhe gratë e prekura nga dhuna mund të kenë nevoja të veçanta të cilat mund të ndikojnë në kërkimin e punës dhe llojin e punës që është e përshtatshme për situatën në të cilën ndodhen ato. Dhuna në familje mund të ketë një ndikim negativ

në besimin dhe fokusin e vajzave dhe grave në kërkimin e punës. Ekspozimi ndaj abuzimit në familje mund të krijoj pengesa për punësimin e ardhshëm, sepse gratë humbasin aftësinë për të jetuar të pavarura, ato mund të izoloohen dhe kanë më pak gjasa të përfshihen në përvoja pozitive të të mësuarit.

Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave dhe punësimi i tyre është faktor thelbësor në përballimin e shkaqeve bazë, të mundshme, të dhunës, varfërisë dhe mungesës së mjeteve ekonomike. Sipas Konventës së Stambolli, viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore duhet të kenë akses ndaj shërbimeve që mundësojnë rimëkëmbjen e tyre nga dhuna, përfshirë këshillimin ligjor dhe psikologjik, ndihmën financiare, strehimin, shkollimin, trajnimin profesional dhe ndihmën për të gjetur punë (Neni 20).

Ligji 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" përcakton si përfituese/përfitues të ndihmës ekonomike ndër të tjera viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre si dhe viktimat e dhunës në familje, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, të cilat nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

Ligji Nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit" dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij kanë mundësuar programe për nxitjen e punësimit që mund të lehtësojnë procesin e ri/integrimit. Të rëndësishme janë: Programe të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale" – VKM Nr.17 datë 15.01.2020; Programe të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit" - VKM Nr. 348, datë 29.4.2020; Programi i punëve publike në komunitet - VKM Nr. 535 datë 08.07.2020⁴⁴.

Të mbijetuarat kanë mundësi të përfitojnë nga dy skema të tjera mbështetëse si, Mbështetje për sipërmarrjet e vogla dhe Skema Biznesit Social, të cilat synojnë aftësimin e marrjes së përgjegjësisë dhe riintegrimin të këtyre grave.⁴⁵

Viktimat e trafikimit përfitojnë përjashtim nga tarifat e kursit të formimit profesional, me kushtin që të jenë regjistruar si të papuna. Kurset e formimit profesional, zakonisht i mundësohen grave nëpërmjet bashkëpunimit me Zyrën Rajonale të Punësimit (ZRP) të AKPA.

Me anë të Ligjit Nr.65/2016, "Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë", janë njohur edhe në Shqipëri ndërmarrjet sociale si organizata jofitimprurëse të cilat kanë për qëllim punësimin e personave që janë të pafavorizuar në tregun e punës, si: personat që trajtohen me ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, jetimët(et), gratë viktimat të dhunës dhe trafikimit etj. Në zbatim të këtij ligji, është

44 Te Ndryshem dhe te Barabarte. Modeli i riintegrimin për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore

45 Te Ndryshem dhe te Barabarte. Studimi mbi "Modelin e riintegrimin për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore"

miratuar VKM Nr. 56, datë 31.01.2018 "Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara". Në pikën 1 të tij përcaktohet se ndërmarrjet sociale kontribuojnë në mbrojtjen sociale dhe mbështetjen e personave e të grupeve të pafavorizuara nëpërmjet punësimit dhe lehtësimit të aksesit në tregun e punës. Kjo VKM përcakton si një ndër grupet e pafavorizuara gratë dhe vajzat viktimat/viktima të mundshme të trafikimit, të shfrytëzimit dhe të dhunës në familje.

Sfidat

- MKR-të bëjnë përpjekje për të ofruar shërbime të riintegritimit për të mbijetuarat e DHF posaçërisht me fokus në formimin profesional dhe punësimin. Ndërkohë që regjistrimi në kurset e formimit profesional është i lehtë për shkak të bashkëpunimit të mirë me Zyrën Rajonale të Punësimit (ZRP), punësimi i të mbijetuarave të DHF vazhdon të mbetet një sfidë, me gjithë përpjekjet dhe koordinimin midis ZRP-ve, KVDHF+NBGJ-ve/bashkive dhe bizneseve vendase⁴⁶.
- Shpesh të mbijetuarat e DHF refuzojnë mundësitë e punësimit të ofruara nga bizneset vendase duke preferuar ndihmën ekonomike e cila është më e vogël në vlerë monetare, por e sigurt dhe i lejon ato të qëndrojnë në shtëpi dhe të kujdesen për fëmijët⁴⁷. Ka raste që kjo lidhet dhe me frikën e madhe që ato kanë nga dhunuesi dhe pasigurisë që mund të dhunohen përsëri edhe në vendin e punës.
- Mungesa e shërbimeve publike të arritshme si transporti i sigurt publik, çerdhet, kopshtet dhe shkollat pranë shtëpisë i pengon të mbijetuarat e DHF të pranojnë oferta punësimi.
- Shumë bashkive ju mungojnë stimujt financiarë për fuqizimin ekonomik të grave në nevojë, ku të mbijetuarat e DHF mund të jenë kategori përfituese.
- Punësimi i të mbijetuarave të DHF në zonat rurale është më i vështirë për shkak të mungesës së mundësive dhe vetë-punësimit në bujqësi, ku toka është në pronësi të burrit ose burrave të familjes⁴⁸.
- Informacioni zyrtar mbi vendet e punës jo gjithmonë shpallet dhe kjo kufizon mundësitë që zyrat e AKPA-s apo institucionet e tjera të ndihmës të mbështesin punësimin e viktimave⁴⁹;
- Sipas viktimave shqetësim përbën mungesa e punësimit të përshtatshëm për rastet me KEMP, rastet kur gratë janë me edukim të lartë, tjetër shqetësim

46 UNDP, UN Women dhe UNFPA (2019). Analiza e Funkcionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje në Nivel Vendor në Shqipëri

47 UNDP, UN Women dhe UNFPA (2019). Analiza e Funkcionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje në Nivel Vendor në Shqipëri

48 UNDP, UN Women dhe UNFPA (2019). Analiza e Funkcionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje në Nivel Vendor në Shqipëri

49 "Të Nryshëm & Të Barabartë" (2022). Studimi mbi "Mundësitë për të zhvilluar plane të suksesshme riintegrimi të viktimave të dhunës me bazë gjinore në bashkitë Kukës, Dibër, Korçë dhe Berat"

- janë dhe oraret e tejzgjatura të punësimit në biznese⁵⁰.
- Shqetësim përbën edhe mbrojtja e të drejtave të punës të viktimave të dhunës me bazë gjinore të punësuar. Edhe pse mund të ketë pakënaqësi lidhur me pagën, me orët e punës, pushimin pa të drejtë nga puna etj., përveçse hezitimit për të kërkuar të drejtat, ekziston edhe mungesa e informacionit mbi ku duhet të drejtohen të punësuarit dhe largësia prej autoriteteve të inspektimit⁵¹.
- Viktimat e dhunës në familje nuk janë mësuar të punojnë, duke qenë se shumicën e kohës kanë qenë shtëpiake; ju mungon mbështetja e duhur psiko-sociale për të filluar punë. Edhe në rastet kur punësohen e kanë të vështirë të mbajnë vendin e punës.

Praktikat e mira

Disa nga bashkitë kanë prezantuar masa pozitive për të inkurajuar drejtpërdrejtë punësimin e të mbijetuarave të DHF dhe punësimin e grave në nevojë në nivel vendor. Ekzistojnë gjithashtu disa modele pozitive që hasen kryesisht në bashkitë ku organizatat vendore ofrojnë shërbime të formimit profesional për të lehtësuar punësimin e grave vulnerabël, përfshirë të mbijetuarat e DHF. Të Mbijetuarat e Dhunës me Bazë Gjinore mbështeten hap pas hapi në përpjekjet e tyre për të hyrë në tregun e punës, nëpërmjet këshillimit për punësim dhe zhvillimin e karrierës. Në seanca individuale dhe grupi mësohen aftësi praktike se si të shkruhet një CV, një letër interesi, si të përgatitesh për një intervistë pune. Është e rëndësishme që mbështetja të vazhdojë deri në punësimin e qëndrueshëm, kryerjen e një internshipi me pagesë apo hapjen e një biznesi të tyre.

50 "Të Ndryshëm & Të Barabartë" (2022). Studimi mbi "Mundësitë për të zhvilluar plane të suksesshme riintegrimi të viktimave të dhunës me bazë gjinore në bashkitë Kukës, Dibër, Korçë dhe Berat"

51 "Të Ndryshëm & Të Barabartë" (2022). Studimi mbi "Mundësitë për të zhvilluar plane të suksesshme riintegrimi të viktimave të dhunës me bazë gjinore në bashkitë Kukës, Dibër, Korçë dhe Berat"

M. ishte vetëm 16 vjeç kur iu desh të fillonte jetën e saj nga e para. Ajo kishte një jetë të vështirë në qytetin e saj, kishte përjetuar dhunë fizike dhe psikologjike nga babai i saj dhe kishte qenë viktimë e abuzimit seksual.

Tre vjet më parë ajo nisi një jetë të re në Tiranë së bashku me nënën e saj të sëmurë. Ajo u bë pjesë e programit të riintegritimit të organizatës dhe u mbështet për të filluar një kurs profesional gatimi. Pas përfundimit të kursit, ajo filloi një internship me pagesë si ndihmës/kuzhinierë pranë një biznesi.

M. thotë se kjo ishte një ëndërr e saj që e vogël, kur ndihmonte nënën e saj në përgatitjen e gatimeve dhe vakteve shtëpiake, por tashmë kjo ëndërr u kthye në profesion.

Jam shumë e lumtur sepse tani kam një profesion dhe punoj në një biznes të njohur dhe të respektueshëm. Ndihem shumë mirë dhe e sigurtë në ambientin e punës. Me të ardhurat që fitoj ndihmoj veten dhe familjen time që të kemi një jetë më të mirë.

Dhe e gjithë kjo, falë mbështetjes që më është dhënë në kohën e duhur!

M. përfituese e programit të riintegritimit D&E

Rekomandime

- Informimi i grave dhe vajzave për mundësitë e punësimit që ofrohen në komunitet.
- Ofrimi i kurseve profesionale bashkëkohore që rrisin mundësitë e punësimit të grave dhe vajzave në tregun e punës.
- Pagesa e transportit për gratë dhe vajzat nga zonat rurale që ndjekin kurse profesionale në qendrat urbane të bashkive/qarqeve.
- Hartimi i planeve individuale të zhvillimit të karrierës dhe punësueshmërisë dhe ofrimi i mbështetjes për gjetjen e një vendi pune dhe integrimin në tregun e punës.
- Ndërgjegjësimi dhe organizimi i takimeve të vazhdueshme me bizneset lokale dhe institucionet për rritjen e ndjeshmërisë për punësimin e grave dhe vajzave që vijnë nga situata të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.
- Regjistrimi i fëmijëve të të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore në çerdhe dhe kopshte me qëllim që nënat të mund të integrohen në tregun e punës.
- Ngritja e Alternativave të Kujdesit për fëmijët e nënave që punojnë me orar të zgjatur që e tejkalon orarin e çerdheve, kopshteve dhe shkollave publike.
- Përshtatja e programeve të punësimit sipas nevojave të grupeve vulnerable me qëllim rritjen e aksesit dhe përfshirjes në këto programe.

NDIHMA DHE SHËRBIMET PËR FËMIJËT E VIKTIMAVE TË DHBGJ

Përshkrimi i shërbimit

Të jetosh në një shtëpi të dhunshme mund të ketë efekte afatgjata te fëmijët. Disa fëmijë preken më shumë se të tjerët. Por të gjithë fëmijët priren të ndikohen nga situatat e dhunës që shohin në familje dhe shpesh kopjojnë sjelljen e të rriturve në familjen e tyre. Efekti i lëndimit nga dhuna, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose të tërthortë, mund të ketë ndikim shkatërrues mbi fëmijët. Fëmijët kanë të drejtë të kenë akses në shërbimet që janë të përshtatshme për moshën e tyre, janë të ndjeshme dhe miqësore ndaj tyre.

Burimet mbështetëse për nënat dhe fëmijët që po përballen me këtë problem dhe që po largohen nga marrëdhëniet abuzive janë thelbësore (strehëzat e urgjencës së grave; strehimi dhe ndihma financiare; asistenca për kujdesin ndaj fëmijëve; avokatia dhe shërbimet ligjore; këshillimi mbështetës; shërbimet shëndetësore; shërbimet arsimore për fëmijën, etj)

Fëmijët e ekspozuar ndaj abuzimit të dhunës në familje duhet të ndihmohen nga profesionistët që punojnë në sektorët e shëndetësisë, shëndetit mendor, shërbimit social dhe arsimin. Mbeshtetja psikologjike dhe emocionale për fëmijën duhet të ofrohet në të gjitha rastet pasi kjo do të ndihmonte në të kuptuarin e situatës që është duke kaluar familja. Gjithashtu është shumë e rëndësishme që të punohet me nënën dhe pjesën tjetër të familjes sesi të mbështesin fëmijën dhe të kuptojnë nevojat që ka ai/ajo.

Konventa e Stambollit përfshin disa dispozita që adresojnë këtë çështje. Ajo kërkon që të gjitha masat e mbrojtjes të marrin parasysh marrëdhëniet midis viktimave, autorit të krimit, fëmijëve dhe mjedisit të tyre më të gjerë shoqëror. Qëllimi është të shmangët një situatë kur viktimat dhe nevojat e tyre adresohen në mënyrë të veçuar ose pa pranuar realitetin e tyre shoqëror (neni 18, paragrafi 3). Konventa e Stambollit gjithashtu kërkon mbështetje të specializuar për fëmijët në situata të tilla (nenet 22, 23 dhe 26) bazuar në nevojat e tyre. Prokurorët dhe gjyqtarët duhet t'u sigurojnë fëmijëve viktimat dhe dëshmitarëve fëmijë mbrojtje të veçantë në të gjitha fazat e hetimeve dhe procedurave gjyqësore (neni 56). Interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë parimi udhëzues kur fëmijët vijnë në kontakt me sistemin e drejtësisë si rezultat i dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje.

Sipas Ligjit Nr. 18/2017 Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës bashkitë janë përgjegjëse për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative në varësi të tyre të strukturave përkatëse për mbrojtjen e fëmijës, në zbatim të standardeve dhe, nëpërmjet tyre, të një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijës. Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki ngrihet dhe funksionon si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe ka për detyrë, në mënyrë të posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen

dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje. Vendimi Nr.327, datë 2.06.2021 Përmekanimin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës parashikon që ekipi teknik ndërdisiplinore (ETN), në bashkëpunim me grupin teknik ndërsektorial për të drejtat e fëmijëve (GTN), organizojnë mbledhje të përbashkëta rast pas rasti, kur dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave shoqërohet edhe me dhunën ndaj fëmijëve ose kur përshihen fëmijët si dëshmitarë të dhunës në marrëdhëniet familjare. Viktimat në moshë të mitur trajtohen në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë njësisë vendore përkatëse duke vlerësuar nevojat e tyre dhe ofruar shërbimet e nevojshme.

Personave të dhunuar dhe fëmijëve të tyre duhet tu ofrohen shërbime arsimore dhe edukative. Psikologët dhe punonjësit sociale të shkollave ku studiojnë fëmijet e të mbijetuarave të dhunës në familje duhen informuar për t'i patur ata nën vëzhgim dhe për tu ofruar këshillime. Në bashkëpunim me bashkinë dhe OJF, fëmijet e të mbijetuarave të dhunës në familje ndihmohen me paketa dhe artikuj shkollorë si edhe disa bashki i mbështesin me pagesën e çerdhes / kopshtit.

Sfidat

- Ekspozimi i fëmijëve tek dhuna, ndryshimet në vendbanim, të shkollës, largësia prej të afërmeve, bullizmi në shkollë dhe në lagje, humbja e shokëve, veshja, ushqim, mbarëvajtja në mësim, realizimi i talenteve të tyre janë nevoja që duhen priorizuar në trajtimin e Të Mbijetuarat e Dhunës me Bazë Gjinore sepse ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në sigurinë dhe mirëqenien e tyre. Adresimi i nevojave të fëmijëve duhet bërë në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në bashki⁵².
- Të mbijetuarat e dhunës në familje raportojnë se faktorë të fortë stresi ishin: siguria e fëmijëve - frika mos dhunuesi kërcënon, dhunon, manipulon fëmijët; dhënia e aksesit abuzuesit nga palë të treta, sidomos nga shkolla; pamundësia-mungesa e të ardhurave për të blerë ushqime dhe veshje për fëmijët; pamundësia për të përballuar blerjen e librave dhe mjeteve shkollorë për fëmijët; ankthi për fëmijët të cilët jetojnë vetëm gjatë kohës që viktimat janë në punë; pamundësia për t'i vendosur fëmijët në kurse për t'i ndihmuar me rezultatet në shkollë⁵³
- Frika mos bashkëshorti mund të marrë fëmijët. Presioni i të afërmeve për t'ia dhënë fëmijët bashkëshortit të dhunshëm. Ankthi i vazhdueshëm për fëmijët-efekti i dhunës, manipulimi i fëmijëve nga abuzuesi; kërcënimet që do marrë shtëpinë;⁵⁴
- Frika e humbjes së kujdestarisë së fëmijëve. Gratë mund të kenë frikë se do t'u merren fëmijët.

52 "Të Ndryshëm & Të Barabartë". Modeli i riintegritit për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore

53 "Të Ndryshëm & Të Barabartë" (2022). Studimi mbi "Mundësitë për të zhvilluar plane të suksesshme riintegrimi të viktimave të dhunës me bazë gjinore në bashkitë Kukës, Dibër, Korçë dhe Berat"

54 "Të Ndryshëm & Të Barabartë" (2022). Studimi mbi "Mundësitë për të zhvilluar plane të suksesshme riintegrimi të viktimave të dhunës me bazë gjinore në bashkitë Kukës, Dibër, Korçë dhe Berat"

Praktikat e mira

“Shtëpia e Gjyshes ose Shtëpia Tjetër”

“Shtëpia e Gjyshes ose Shtëpia Tjetër” është alternativë kujdesi nga profesionistë për fëmijët në një ambient që ngjan me shtëpinë në kohën kur prindërit janë në punë me orare të zgjatura ose punojnë të shtunave.

Qëllimi është kujdesi për fëmijët dhe parandalimi i situatave shoqërore dhe të punësimit për nënat që mund të ndikojnë negativisht në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe për të ndihmuar nënat që të luajnë plotësisht rolin e tyre në familje.

Shërbimet dhe mundësitë e ofruara në alternativën e kujdesit “ Shtëpia e Gjyshes ose Shtëpia Tjetër ” përfshijnë:

- Kujdesi dhe mbikëqyrja e fëmijëve nga një i rritur i përgjegjshëm
- Higjiena dhe shëndeti
 - Ushqimi dhe ushqyerja
- Mbështetje për shkollën / detyrat e shtëpisë
- Mbështetje emocionale dhe mësimi i sjelljeve pozitive sociale
- Lojëra për fëmijë
- Informimi i nënës dhe konsultimi me të lidhur me kujdesin për fëmijën
- Observimi i sjelljeve të fëmijës dhe raportimi i dyshimeve për neglizhim, abuzim apo ekspozim tek dhuna
- Vlerësimi dhe mbështetja psikologjike
- Vlerësimi dhe mbështetja mjekësore

Disa shërbime dhe mundësi ofrohen jashtë qendrës duke përfshirë vlerësimin e nevojave dhe planifikimin e kujdesit, transportin për në , shëtitjet e kohës së lirë, referimin e nënës dhe fëmijës për vlerësimin dhe trajtimin e nevojshëm dhe mbështetje për prindërimin.

Burimi: Të Ndryshë & Të Barabartë (2019) “Shtëpia e Gjyshes ose Shtëpia Tjetër”, Tirana: Të Ndryshëm & Të Barabartë

Rekomandime

- Ndërmarrjen e veprimeve që marrin në konsideratë dhe mbështesin jo vetëm nevojat por edhe interesat dhe hobet e viktimave dhe të fëmijëve të tyre. Të tilla mund të jenë përfshirja në paketën riintegruese të: mbështetjes financiare për kurset e talenteve të fëmijëve (gjuhë të huaja; balet, futboll, etj.)⁵⁵;
- Rritja e bashkëpunimit midis koordinatorit vendor të dhunës dhe punonjësit të mbrojtës së fëmijëve për adresimin e menjeherëshëm të nevojave që ka fëmija.
- Stafi i shërbimit psiko-social në kopshte, shkolla duhet të ofroj mbështetje

55 “Të Ndryshëm & Të Barabartë” (2022). Studimi mbi “Mundësitë për të zhvilluar plane të suksesshme riintegrimi të viktimave të dhunës me bazë gjinore në bashkitë Kukës, Dibër, Korçë dhe Berat”

të vazhdueshme për këta fëmijë dhe të monitoroj sjelljet dhe nevojat e tyre ne vazhdim.

INFORMIMI DHE REFERIMI

Përshkrimi i shërbimit

Informimi i viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore për të drejtat njerëzore, gamën dhe natyrën e shërbimeve që janë në dispozicion është një domosdoshmëri dhe duhet të jetë i vazhdueshëm. Informacioni duhet të ofrohet në mënyrë të tillë që t'u bëjë të mundur viktimave të marrin parasysh gamën e shërbimeve dhe alternativave që kanë në dispozicion, dhe të bëjnë zgjedhjet e tyre. Informacioni duhet t'u vihet në dispozicion viktimave që përjetojnë dhunë, si dhe familjeve e miqve, kolegëve të punës, policisë dhe shërbimeve shëndetësore, të cilët mund të luajnë rol për t'u ardhur në ndihmë viktimave për t'i marrë këto shërbimet në mënyrë të sigurt, kur zgjedhin ta bëjnë këtë gjë. Informimi i grave dhe vajzave mbi dhunën me bazë gjinore, shërbimet mbështetëse është një hap shumë i rëndësishëm në fuqizimin e tyre.

Konventa e Stambollit u bën thirrje shteteve të sigurojnë që viktimat të kenë të drejta të caktuara: Informimi i duhur, në kohë për shërbimet e mbështetjes në dispozicion dhe opsionet ligjore në gjuhën që ata e kuptojnë (neni 19). Ligji nr. 9669, datë 18. 12. 2006 "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" i ndryshuar parashikon në nenin 8 që autoritetet përgjegjëse përdorin mjetet e arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar vazhdimin e dhunës me anë të: informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj për masat që do të merren sipas ligjit në fuqi dhe për institucionet të cilave duhet t'u drejtohet; informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj në lidhje me shërbimet sociale ekzistuese dhe shoqërimin në qendrat dhe institucionet përkatëse.

Të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore kanë të drejta të caktuara dhe duhet të informohen për ato të drejta. Të mbijetuarat duhet të informohen mirë në mënyrë që të marrin vendimet e tyre për pjesëmarrjen në të gjitha fazat e procesit të drejtësisë penale, të kuptojnë të gjithë të drejtat që ato kanë. Nuk rekomandohet thjesht të lexohet një listë e të drejtave të të mbijetuarës. Është më efektive të zhvillohet një bisedë me të mbijetuarën, detyrimet dhe të drejtat e saj, të cilat do ta lejonin atë të bënte pyetje. Biseda të tilla duhet të zhvillohen sa më herët që të jetë e mundur. Një praktikë e mirë është t'i shpjegohen të mbijetuarës personalisht të drejtat e saj dhe t'i sigurohen materiale me shkrim që e mbijetuarja të mund të konsultohet më vonë.

Sfidat

- Një pjesë e viktimave, sidomos në fazat e para të ndihmës, nuk kanë informacion të detajuar mbi të drejtat, kohën e ndihmës, elementët, kriteret, etj., dhe kjo e rrit pasigurinë e tyre⁵⁶;
- Përshkak të mungesës së ekspozimit me institucionet dhe shërbimet e ndryshme e kanë të vështirë në fillim që të kërkojnë akses në shërbime dhe ju mungon informacioni sesi të aplikojnë, përfitojnë.

Praktikat e mira

Organizatat bëjnë informimin e viktimave për të drejtat e tyre në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme dhe lidhur me procedurat që duhet të ndjekin për marrjen e shërbimëve të caktuara.

Informimi nga organizatat jofitimprurëse realizohet nëpërmjet:

1. Sesioneve informuese për:

A. Përfituesit e organizatës (të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore) dhe komunitetin në përgjithësi (informim për fenomenin e dhunës me baze bazë gjinore, ku mund të referohen dhe shërbimet që ofrohen nga institucionet dhe organizatat, si dhe informohen për të drejtat e tyre).

B. Institucionet që janë përgjegjëse për mbrojtjen e të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore lidhur me bazën ligjore të mbrojtjes së viktimave të dhunës (ndryshimet ligjore).

2. Trajnime me punonjësit e institucioneve për informimin e të drejtave dhe aksesin në drejtësi për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore.

3. Informim për të drejtat e viktimave me fletëpalosje duke përshkruar të drejtat e viktimave dhe ku mund të drejtohen për ndihmë dhe mbështetje.

Rekomandime

- Përmirësimi i procesit të dhënies, cilësisë dhe sasisë së informacionit që i jepet viktimës që garanton informimin dhe sqarimin e vazhdueshëm lidhur me të drejtat, kohën e ndihmës, elementët, kriteret etj⁵⁷;
- Të punohet me komunitetin për ndërgjegjësimin mbi të drejtat e viktimave të dhunës me bazë gjinore;
- Zhvillimi i strategjive të komunikimit që targetojnë nevojat specifike për informacion të grave dhe vajzave dhe grupeve të tjera vulnerable;
- Rritja e ndërgjegjësimin, në komunitete urbane dhe rurale për kuadrin ligjor kombëtar dhe Konventat Ndërkombëtare, ofrim i trajnimeve për sensibilizim gjinor për institucionet përgjegjëse në zbatimin e ligjeve.

56 Të Ndryshëm & Të Barabartë” (2022). Studimi mbi “Mundësitë për të zhvilluar plane të suksesshme riintegrimi të viktimave të dhunës me bazë gjinore në bashkitë Kukës, Dibër, Korçë dhe Berat”

57 Të Ndryshëm & Të Barabartë” (2022). Studimi mbi “Mundësitë për të zhvilluar plane të suksesshme riintegrimi të viktimave të dhunës me bazë gjinore në bashkitë Kukës, Dibër, Korçë dhe Berat”

V. REKOMANDIME DHE KONKLUZIONE

Riintegrimi i grave viktime të dhunës që janë larguar nga mjedisi i dhunshëm është një proces kyç që plotëson sistemin e mbrojtjes kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Riintegrimi dhe mundësitë për të patur akses në shërbime e bëjnë më të lehtë marrjen e vendimit për t'u larguar, por edhe sigurimin e strehimit dhe punësimit, si dhe rikuperimin nga dhuna. Qëllimi afatgjatë i riintegritit është një jetë pa rrezikun e dhunës në të ardhmen dhe pa rrezikun e varfërisë.

Gratë dhe vajzat të mbijetuara nga dhuna me bazë gjinore kanë mundësinë t'i drejtohen një sërë institucioneve në nivel qendror dhe vendor. Rrethi i parë i shërbimeve përfshin Drejtoritë e Shërbimit Social në Bashki, Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe Komisarariatet e Policisë së Shtetit, si dhe një sërë institucionesh të tjera qendrore dhe vendore.

Këto institucione kanë detyrimin për të informuar, mbështetur dhe ofruar shërbime si: ndihmë mjekësore, këshillim psiko-social, ndihmë ligjore, strehim në strehëzat e emergjencës, dhënia e informacionit dhe asistencës për marrjen e urdhrave të mbrojtjes (UM), referimi në shërbime të mëtejshme, etj. Shërbime afatgjata, si mbështetja me punësim, asistencë sociale, strehim, këshillim ligjor dhe ndihmë me procedurat e divorcit, këshillim dhe psiko-terapi, ndihmë për fëmijët. Në mungesë të plotësisimit të nevojave me shërbime nga institucionet vendore janë organizatat joqeveritare që ofrojnë shërbime të ndryshme riintegruese për viktimat e dhunës me bazë gjinore.

Bashkitë duhet të shtojnë shërbimet dhe të rrisin cilësinë e tyre për riintegrim të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore. Disa nga ndërhyrjet më prioritare janë:

- Nevoja për mbështetje dhe shërbime afatgjata të strukturuar dhe shumëdimensionale për të mbijetuarat e DHBGj, dhe aplikimin e qasjeve që sigurojnë riintegrimin dhe parandalojnë abuzimet e mëtejshme.
- Ndërtimi i planeve të riintegritit ndersektorial nga Bashkitë për mbështetjen për rintegrim e viktimeve të DHBGJ dhe parashikimi i burimeve të nevojshme për ti zbatuar këto plane.
- Rritja e buxheve të planifikuara nga ana e institucioneve vendore në lidhje me përfshirjen në programet e strehimit social të viktimeve të DHBGJ-së dhe viktimeve të trafikimit
- Informimi i grave dhe vajzave dhe ofrimi i kurseve profesionale bashkëkohore që rrisin mundësitë e punësimit të grave dhe vajzave në tregun e punës.

- Hartimi i planeve individuale të zhvillimit të karrierës dhe punësueshmërisë dhe ofrimi i mbështetjes për gjetjen e një vendi pune dhe integrimin në tregun e punës.
- Ndërgjegjësimi dhe organizimi i takimeve të vazhdueshme me bizneset lokale dhe institucionet për rritjen e ndjeshmërisë për punësimin e grave dhe vajzave që vijnë nga situata të dhunës në familje dhe dhunës më bazë gjinore.
- Regjistrimi i fëmijëve të të mbijetuarave të dhunës më bazë gjinore në çerdhe dhe kopshte me qëllim që nënat të mund të integrohen në tregun e punës.
- Ndjekja e të mbijetuarave të dhunës në familje gjatë aksesit të shërbimeve sociale dhe psikologjike për tu siguruar që ata përfitojnë dhe kanë progres në adresimin e nevojave të tyre
- Rritja e bashkëpunimit midis koordinatorit vendor të dhunës dhe punonjësit të mbrojtës së fëmijëve për adresimin e menjeherëshëm të nevojave që ka fëmija.
- Ofrimi i mbështetjes dhe monitorimi i nevojave të fëmijëve nga stafi i shërbimit psiko-social në kopshte, shkolla për një integrim dhe përshtatje edhe në rastet kur ju duhet të ndryshojnë institucionet e edukimit.
- Advokimi, ndërgjegjësimi dhe përmirësimi i njohurive mbi dhunën në familje, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën ndaj grave e vajzave, si dhe shërbimet e MKR-ve me objektiv profesionistët që trajtojnë këto forma dhune (policia, qendrat shëndetësore, shkollat, zyrat e punësimit dhe media, etj) për parandalimin dhe adresimin e tyre.
- Rritja e kapaciteteve të punonjësve të shëndetësisë që të njohin faktorët e rrezikut, shenjat, problemet ose kushtet që paraqesin, duke përfshirë modelet e sjelljes shtrënguese ose kontrolluese të lidhura me abuzimin në familje dhe të lehtësojnë procesin e ndarjes së informacionit nga e mbijetuara e dhunës në familje.
- Ngritja e shërbimeve të shëndetit mendor lehtësisht të aksesueshme pranë qendrave komunitare në çdo bashki.
- Rritja e njohurive ligjore dhe aksesit në këto shërbime të popullatës vecanërisht të grave dhe grupeve të tjera të marginalizuara për të rritur aksesin në shërbimet që ofrohen nga sistemi i drejtësisë.
- Ofrimi i trajnimeve për tema mbi barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore, të drejtat e grave dhe vajzave me qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve, grave dhe vajzave mbi normat sociale, traditat dhe rolet e pabarabarta gjinore.
- Zhvillimi i strategjive të komunikimit që targetojnë nevojat specifike për informacion të grave dhe vajzave dhe grupeve të tjera vulnerable.
- Në momentin e lëshimit të UM, gjykata duhet që të informoj viktimën e dhunës me bazë gjinore për të kontaktuar koordinatoren vendor të dhunës në familje në bashki me qëllim që të marr shërbimet e nevojshme.
- Ofrimi i supervizimit për stafet që ofrojnë shërbime për kategori të ndryshme

me qëllim zvogëlimin e stresit, konsumimit profesional por edhe diskutimin e rasteve të vështira me të cilat përballen profesionistët.

- Harmonizimi i të gjithë regjistrave (regjistri elektronik kombëtar, REVALB, etj) për të gjithë aktorët është i rëndësishëm me qëllim që të shmangen rastet që ka mbivendosje të shërbimeve dhe bashkia të marr informacion për rastet që janë ndihmuar nga OJF-të dhe që jo gjithmonë punonjësit e bashkisë kanë informacion.

VI. REFERENCA

- AGJZH (2021). Shërbime rehabilitimi dhe riintegrimi brenda sistemit të mirëqenies sociale në Republikën e Shqipërisë për gratë e mbijetuara nga dhuna
- Avokati i Popullit. (2020). raport alternativ mbi zbatimin e konventës CEDAW në Shqipëri 2016 - 2020
- DCM No. 505 dated 13.07.2011 "On adopting social care service standards for domestic violence victims in public and non-public residential centers", and Regulation No. 13 dated 17.12.2012 "On the implementation of social care service standards for domestic violence victims in public and non-public residential centers".
- DCM No. 195, dated 11.04.2007 "On adopting social care services standards in residential centers for trafficked persons or persons at risk of being trafficked"
- Instruction No. 774 dated 15.11.2019 "On adopting minimum social care service standards for gender based violence and domestic violence victims/ survivors in public and nonpublic emergency (short term) residential centers (emergency shelters)".
- INSTAT. (2020). Burrat dhe Gratë në Shqipëri.
- Grupi i Ekspertëve për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA), 2016, Raport në lidhje me zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore nga Shqipëria;
- Ligji i nr. 22/2018 "Për Strehimin Social" është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 79, datë 30 maj 2018
- MB & IOM. (2016). Plan veprimi Për riintegrimin socioekonomik të grave dhe vajzave viktime të trafikimit të personave.
- M.Sh.M.S& UNDP. (2019). Raport Përfundimtar. Analiza e Funkcionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje në Nivel Vendor në Shqipëri. Qeveria e Suedisë, UN Women dhe UNFPA.
- MSHMS & UNDP. 2020. Cfare duhet te dime per dhunen seksuale dhe ate me baze gjinore

- Surtees, R., M. Meshi, S. Tanellari, A. Lila, O. Hinaj and B. Meçaj (2022) Mbështetja e fëmijëve të viktimave të trafikimit. Udhëzues riintegrimi për profesionistët. Tiranë: Të Ndryshëm & Të Barabartë dhe Ëashington, D.C.: NEXUS Institute.
- Të Ndryshëm dhe të Barabartë. Studimi mbi "Mundësitë për të zhvilluar plane të suksesshme riintegrimi të viktimave të dhunës me bazë gjinore në bashkitë Kukës, Dibër, Korçë dhe Berat"
- Të Ndryshëm dhe të Barabartë. Studimi mbi "Modelin e riintegrimit për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore"
- Të Ndryshëm dhe të Barabartë, (2020). Riintegrimi i të mbijetuarave nga dhuna me bazë gjinore.
- UNDP, UN Women dhe UNFPA (2019). Analiza e Funkcionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje në Nivel Vendor në Shqipëri
- Universiteti i Bedfordshire dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin. (IOM), 2019, "Midis dy zjarreve": Kuptimi i cenusshmërive dhe nevojave për mbështetje të personave nga Shqipëria, Vietnam dhe Nigeria që kanë përjetuar trafikim njerëzor në MB".
- UNDP, 2018. Studim mbi aksesin në drejtësi në Shqipëri
- Raport studimor - Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri
<https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/Raport-Studimor-Dhuna-ndaj-Grave-dhe-Vajzave-ne-Shqiperi.pdf>
- Urdhër Nr. 100, datë 21.2.2020 Për procedurat standarde të veprimit (PSV) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore nga punonjëset/ punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të mekanizmave të koordinuar të referimit
- Urdhër Nr. 101, datë 21.2.2020 Për miratimin e procedurave standarde të veprimit (PSV) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore nga punonjëset/punonjësit e shërbimeve shëndetësore, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të mekanizmit të koordinuar të referimit WHO. (2021). Violence against Women Prevalence Estimates, 2018. Retrieved from
<https://www.who.int/publications/i/item/violence-against-women-prevalence-estimates>
- Vendim Nr. 327, datë 2.06.2021 Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës
- www.shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/02/Paketa_e_rishikuar_e_miratuar.pdf

